



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Bujar Lushaku	26.10.2023	06.11.2023	2023/0787

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 12.10.2023, OE “DESHISHKU GB SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0787, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Zgjerimi i rrjetit të Kanalizimit, pastrimi i kanalizimit, Pusetave dhe shtratit të lumejve në Qytet dhe Periferi.” me nr. të prokurimit: "642-23-849-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL MITROVICË.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratit: punë, vlera e parashikuar e kontratit: 550,000.00 €. Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr.2023/0206.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankesës.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me likin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L092, (në tekstin e mëtejshëm do të referohemi LPP-së)

Neni I, Qëllimi, par 2 dhe 3.

Neni 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti.

Neni 7, Barazia në trajtim/Jo diskriminimi, par 1,2 dhe 6;

Neni 59, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 60, Kriteret për Dhënien e Kontratës, par I, nen par I. I

-Dispozitat e Rregullores nr. 01/2022 të prokurimit publik (RRPP)

-Neni 43 Ndërprerja e procedurave të prokurimit, par, 43.5, 43.7

-Neni 97, Shkeljet e rënda, par 97.1 nen par (d), (e), (h), (o).

UDHËZUESI Nr.001/2023 PER PROKURIMIN PUBLIK.

Neni II . Tenderët Jo-normalisht të Ulët, par 11.1

Mos respektimi i Vendimit të Panelit Shqyrtues, nr. OSHP:2023/0206 të datës: 19.07.2023

6. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së, Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar përfaktet dhe argumentet të cila mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Pretendimi ynë ankimor ka të bëjë me diskriminimin e vazhdueshëm që Autoriteti Kontraktues KUVENDI KOMUNAL MITROVICË po me dy vendime ndaj neve si Operator Ekonomik: "Gashi Ing" SH.P.K. & "DESHISHKU GB" SH.P.K.

Me date 05.04.2023 është publikuar Vendimi i Autoritetit Kontraktues B58 dhe ne si operatorë ekonomik me oferte të përgjegjshme me çmim më të lirë në këtë procedurë prokurimi, kemi pranuar letrat standarde për tenderuesin e eliminuar B42, me arsyetimin plotësisht të pabazuar kinse nuk kemi përmbushur Kapacitetin Teknik dhe Profesional respektivisht kontrata të ngjajshme në vlerën e kërkuar dhe këtë ne me plotë të drejtë e kundërshtuam dhe njëkohësisht e argumentuam edhe pse e argumentuar ka qenë me dorëzimin e ofertës tonë, mirëpo Autoriteti Kontraktues KUVENDI KOMUNAL MITROVICË nuk e ka

konsideruar si të tillë Mirëpo oferta jonë si e përgjegjshme u argumentua nga Paneli Shqyrtues i Prokurimit Publik sipas vendimit: 2023/0206. Përmes të cilit vefletohen në plotëni argumentet tona, anulohet vendimi i AK-së dhe lenda kthehet në Ri-vlerësim. (shih më poshtë. Vendimin).

Vendimi i Panelit Shqyrtues: 2023/0206

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**DESHISHKU GB SH.P.K.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Zgjerimi i rrjetit të Kanalizimit, pastrimi i kanalizimit, Pusetave dhe shtratit të lumejve në Qytet dhe Periferi.**” me numër të prokurimit: “**642-23-849-5-1-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KUVENDI KOMUNAL MITROVICË**

OSHP; 2023/0206

Paneli Shqyrtues, i nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 041—042. i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/1--237, Ligjin 05" 1.-068, dhe Ligjin 05/ L•092), në përbërje nga: Agon Ramadani - Kryetar, Vedat Poterqoi Anctar, Vjosa Gradina - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) "Deshishku GB" sh.p.k., me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Zgjerimi i rrjetit të Kanalizimit, pastrimi i kanalizimit, Pusetave dhe shtratit të lumejve në Qytet dhe Periferi", me numër të prokurimit 642-23-849-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Kuvendi Komunal Mitrovicë, me datën 19.07.2023, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE "Deshishku GB" sh.p.k., me nr. 202Y206, e datës 14/04/2023, kurse vendimi i AK Kuvendi Komunal Mitrovicë lidhur me aktivitetin e prokurimit "Zgjerimi i rrjetit Kanalizimit, pastrimi i dhe shtratit të lumejve në Qytet dhe Periferi", me numër të prokurimit 642-23-849-5-1-1, ontlohet. ndërkohë aktiviteti i prokurimit kthehet, në Rivlerësim.

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërfutur masë ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parasllihet me dispozitat e nenit 131 të LPP-së.

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa. por pala e pakëuaqur me kërkesëpadi ka të drejtë të drejtohet Gjykatës Komerciale Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi të dorëzohet;

- AK - KUVENDI KOMUNAL MITROVICË
- OE - DESHISHKU GB SH.P.K.

• Arkivësë OSHP-së:

TUTJE, AK KUVENDI KOMUNAL MITROVICË rivlerësimi në vend që të pëtmirësojë gabimet e veta diskriminuese, të pabaza dhe joprofesionale dhe të na shpallë ne si OE fitues, sepse jemi operatori ekonomik me çmimin më të lirë dhe i përgjegjshëm — tashmë kjo e argumentuar edhe nga dy shkallë shqyrtuese të OSHP-së. Mirëpo AK— Mitrovicë prap vazhdon me vendimin diskriminues ndaj nesh, madje tani aplikon standarde të dyfishta në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, përkatësisht nenit 7 paragrafi 2 dhe 6. Ku fillimisht sipas vendimit të datës 05.04.2023, na trajtoi të papërgjegjshëm në mënyrë të gabuar dhe jo të drejtë dhe të një anshme me arsyen kinse nuk kemi përmbushur Kapacitetin Teknik dhe Profesional respektivisht kontrata të ngjajshme në vlerën e kerkuar dhe pas anulimit të këtij vendimi nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së, pastaj pas rivlerësimit AK — Mitrovicë nxjerr vendim të datës 22.09.2023 dhe tani ndërron arsyen e eliminimit kinse për çmime jonormalisht të ulëta. Pra nxjerr vendim në kundërshtim me vetveten (sipas vendimit të parë) si dhe në kundërshtim me Vendimin e OSHP-së nr 2023/0206.

Shih vendimin e datës: 22.09.2023)



Ne rast të anulimit të aktivitetit të prokurimit shëno arsyetimin Për anulim n':

Komisioni i vlerësimit duke u bazuar në Rregulloren për Tenderët JO-Normalisht të Ulët ku KRPP në pajtim me Nenin 87 paragrafi 2 adapton, plotësonë dhe jep sqarime Për tenderët JO-Normalisht të ulët.

A.K. Komuna e Mitrovicës JUGORE ka refuzuar tenderin me numer të prokurimit të lartë cekur si tender me qmimin më të ulët dhe lidhur me këtë ju sqarojmë dhe duke u bazuar në Nenin 3 Informatat e përgjithshme të Rregullat Për Tenderët AB-Normalisht të Ulët dhe duke u bazuar në këtë nen dmth ne Paragrafin 3. I te këtij neni shifet shumë qartë se 3(tre) Operatorët Ekonomik me qmime AB normalisht të Ulët cekur më lartë me qmimet e ofraro në oferten e juaj i përmbushni të gjitha kriteret dhe kushtet e mëposhtme Për tenderët AB-Normotishl të ulët si vijon:

SHPJEGIM: Komisioni i RI-vlerësimit duke u bazuar në Rregulloren Për Tenderët JONormalisht të Ulët ku KRPP në pajtim me Nenin 87 paragrafi 2 adapton, plotësonë dhe jep sqarime Për tenderët JO-Normalisht të ulët sqaron dhe jep arsyetim si më poshtë:

A.K. Komuna e Mitrovicës së JUGUT ka refuzuar tenderin me numer të prokurimit lartë cekur si tender me qmimin më të ulët dhe lidhur me këtë ju sqarojmë dhe duke u bazuar në Nenin 3 Informatat e përgjithshme të Rregullat Për Tenderët JO-Normalisht të Ulët dhe duke u bazuar në këtë nen dmth ne Paragrafin 3,1 te këtij neni shifet shumë qartë se 3(tre) Operatorët

Ekonomik me qmime JO normalisht të Ulët cekur më lartë me qmimet e ofraro në ofertat e tyre i përmbushin të gjitha kriteret dhe kushtet e mëposhtme Për tenderët JO-Normalishl të ulët si vijon:

i. Qmimi ofruar është më shumë se 30% më i ulët se qmimi mesatar i lëndetëve të përgjegjshërn.

II. Qmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se qmimi Ose kostot e tenderit të dytë më të Ulët.

iii. Janë dorëzuar te paktën 3 (tre) tenderë-në rastin konkret janë dorëzuar 4 (katër) tenderë. Pasi tenderët e juaj të cekur më lartë sipas këtij neni dmth Sipas Nenit 3 paragrafi 1 te këtyre rregullave i plotëson të gjitha kushtet Për të qenë TENDER AB-NORMALISHT I ULËT dhe duke u bazuar në besueshmërinë e tenderëve të tillë dhe duke u bazuar në nenin 61 te LPP. së ne si AK kemi vërejtur se edhe qmimet e juaja Për njësi ashtu edhe në total janë shumë të ulta.

Grup i Operatorëve Ekonomik GASHI ING SH.P.K; DESHISHKU GB Sh.p.k. Nebih Hodo Kuqi, Nr 3, Suharekë, kanë Ofertuar me qmime Jo-normalisht të ulta në këto pozicione si vijon: Nga pozicioni poz.2.2 deri 2.6 nga 2.10 deri te poz 2.14, dhe pozicionet 3.1;3.3;3.4;3.5 dhe nga poz.4.1 deri 4.17 qmime JO normalisht të ulta, kurse keni qmime shumë të larta JO-normalisht të ultë në pozicionet si vijon: 1.3 enorm i lartë. qmime enorm të larta ,poz,3.2:3.5:3.10:3.15 qmime enorm te larta në krahasim me qmimet e tregut.

Ne e kundërshtojmë vendimin e AK të datës: 22.09.2023 sepse, është nxjerrë në Shkelje të

dispozitave të lartë cekura, madje ky vendim përveq që është diskriminues është edhe skandaloz Për faktin se është

thirrur në Rregulloren për tenderët Jo-Normalisht të ulët e cila është e shfuqizuar me hyrjen në fuqi të Rregullos nr. 01/2022 të prokurimit publik (RRPP) me datë: 01.11.2022 (Shih argumentin)

Neni 102

Dispozitat e shruqizimit

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohen:

A01 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik — të datës 01.02.2021

2. Udhëzimi Administrativ Nr. 1/2019

3, B57 Rregullat për tenderet Jo-Normalisht të ulët

71, F03 Rregullat për parashtrimin e ankesave

Rregullore Nr. 2/2017 për procedurat e dhënies dhe revokimit të certifikates profesionale për prokurimin publik

6, 1159 Rregullat për Shërbime të veqanta (Konsulentët/Kontraktorët individual) (18.11.2020).

Neni 103

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi me 01 nëntor 2022,

z. Osman Vishaj

Kryetar i KRPP - së



Andaj i tërë vendimi i datës: 22.09.2023 është i pavlefshëm ligjërisht sepse të gjitha dispozitat ligjore paragrafet dhe nenet janë të dokumenteve të shfuqizuara

Sidoqoftë ne i kemi bërë me dije AK— Mitrovicë se ofertojnë nën kushte të bëmë me çmime jo normalisht të ulëta dhe nuk plotësohet asnjëri prej kushteve për të konsideruar çmime jo normalisht të ulëta. Pozicionet në këtë paramasë janë pozicione që ndërlidhen njëra me tjetrën në ekzekutimin e punimeve, dhe

ne asnjë rastë nuk ekzekutohen veq e veq , dhe nëse e marrim një shembull për një punë që duhet të

kyhet del që çmimet tona në total për kryerjen e punëve janë plotësisht në harmoni me çmimei e tregut, këtë e kemi dëshmuar shumë kuartet edhe në përgjigjen e dërguar në AK- Mitrovicë, duke e dëshmuar

se jemi të gatshëm të përfundojmë këtë kontratë sepse kemi kapacitete teknike, profesionale dhe përvojë të specializuar në këtë lëmi, prandaj për t'u siguruar juve ne kemi pranuar që të dyfishojmë Sigurimin e Ekzekutimit. Për më shumë shih në vazhdim elaborimin e detajuar e të argumentuar bashkangjitur përgjigjen e dërguar të datës: 03.09.2023.

DESHISHKU GB

Oato: 03.09.2023.Prishtinë

Nga: "Gaslli Ing" SI-I.P.K. & "DESHISHKU GB"

Për: Zvra e Prokurimit, Komuna e Mitrovicës

Tema: Përgjigje në pyetje të AK për tenderin me titull: Zgjerimi i rrjetit të Kanalizimit, pastrimi i kanalizimit, Pusetave dhe shtratit të lumenjve në Qytet dhe periferi; Me nr. të prokurimit: 642-23-849-5-1-1.

Përgjigja për kërkesën 1 :

Ne Of: Gashi Ing" SH.P.K. & "DESHISHKU GB" SH.P.K., deklarojmë njëzëri që kemi plotësuar pershkrirnin e çmimeve me vetëdije të plotë, dhe të njëjtës i qëndrojmë mrapa.

Për të rritur besueshmërinë tuaj ndaj neve, ne jemi në gjendje të dyfishojmë sigurimin e ekzekutimit të tenderit vetëm për t'ju bërë juve si AK të ndjeheni të sigurtë që nuk do të keni dëme eventuale në lidhje me këtë procedurë të prokurimit. Në jemi OE serioz, ne do të jemi në gjendje të ekzekutojmë të gjitha kërkesat e juaja gjatë ekzekutimit të punëve. Ne me bindje të plotë konsiderojmë që çmimet tona janë normale dhe nuk do të shkaktojnë dëme AK.

Në vendimin tuaj të datës: 05.04.2023 (Njotim mbi vendimin e AK për propozim për shpërbllim me kontratë), i keni citësuar si të përgjegjshëm këta d/ OC: "Curondertimi" dhe "Gani Mlinaku" 8.1. Ndërsa neve si grup i OE na keni cilësuar të pa përgjegjshëm, pastaj ne kemi bërë ankesë në OSHP dhe e njeta e ka cilësuar ankesën tonë plotësisht të bazuar dhe i ka hedhur poshtë pretendimet e

Në këtë procedurë të prokurimit si mbas vendimit tuaj të datës dhe si mbas vendit të OSI-IP së të datës: 19.07.2023, jemi tre OE të përgjegjshëm me çmime si në vijim:

IO. 15C Eurondertimi••

9,85C "Gashi Ing" SH.p.K. "DESHISHKU GB" SH.P.K.

12,62C Mlinaku"

32.62C Vlera totale e çmimit të përbashkët e tre OE,

Mesatarja e çmimit Ofertues të tre OC: 10.87C — 30% 7,60C, ndërsa ne e kemi çrnimin 9,85C, çmimi i ofertuesit të dytë me radhë: 10.15C 10% 9.13C, që do të thotë se asnjëri kusht nuk është plotësuar që ne të jemi me çrnim jo•n

orrnalisht të ulët, pretendimin tuaj e konsiderojmë të pa bazë.

Përgjigja për kërkesën nr. 2 :

Pozicionet 2.2 deri 2.6 në këto pozicione nuk i konsiderojmë si pozicione me çmime të utëta, nga arsya se si pozicione në totalë për tu

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtuar nga OE “**DESHISHKU GB SH.P.K.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Zgjerimi i rrjetit të Kanalizimit, pastrimi i kanalizimit, Pusetave dhe shtratit të lumenjve në Qytet dhe Periferi.**” me numër të prokurimit: “**642-23-849-5-1-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KUVENDI KOMUNAL MITROVICË**

ekzekutuar punimet e kanalit për kanalizim për 1m, totali i ofertës tonë sillet mbi 3G€ per 1m. që do të thotë se mbulohen të gjitha shpenzimet e OE për ekzekutim të punimeve dhe do të japë një profit solid për neve si OE,

DESHISHKU GB

Policionel 2.1 deri 2.14; 3.1; 3.3; 3.4; 3.8 (IIIIC pozicionet deri 1,17 (në paramasë këto pozicione janë cmruar: 4.1 deri 4.5 dhe 4.1, 1 deri 4.7)

Të gjitha këto policione me crnime të ulëta me prejashtim të policioneve 2.12 dhe 3.8 janë të nderlidhura me pozicionet tjera Siq janë: 1.2; 1,13; 2,2; 2,3; 2,5; 2,6; 2,7; 2,9, 2,10 etj. Ti gjitha këto policione me crnime të Ulla dhe pozicionet me crnime pak më të larta, për tu ekzekutuar ndërlidhen njëra me tjetrën, dhe si tilla janë të arsyshme të (regul (Ihr do japin gjatë ekzekutimit të punimeve profit solid për neve si OE.

Si shembull i nderlidhjes së policioneve njërin me tjetren po e tarrim mesalarin e gypave të kanalizimit

PSN8 nga pozicioni deri 1.7 (si crnime të ulëta), Si mesa tarrë e diametrit të gypave po e marrim gypin 315 mm - me policion 4,3. Për tu furnuar me këtë zhavor dhe me njatë tjetër të nevojshme, shpenzimet për ekzekutim të kanalizimit do të kushtojnë rreth 47,750, ndërsa totali i punimeve të ofrlës tone për ekzekutimin e 1m të kanalizimit të gyp PSN8 të 315mm me të gjitha pozicionet e nevojshme arrin vlerën e përafërl të; ofrlës rreth 55.48C. Që dornethanë mesatarja e çmimve ofrluara për një 1m të kanalizimit është 55.48C. Profili për bizneset tona, për 1m do të jetë 7.13C për ml,

MC poshtë po paraqesim policionet me crnime të Ulta dhe crnime të larta të cilat lidhen me këtë aktivitet, si dhe paraqesim crnimet për secilin pozicion si mbasë ofrlës tonë:

Pozicioni është ofrluar me crnim 36

Pozicioni 1.3 është ofrluar me çmim 9.800

Pozicioni; 2,2; 2,3; (pozicionet për germim) është ofrluar me çmim 15.10C/ 3 pozicione

Pozicioni 2,5 është ofrluar me çmim 26€

Pozicioni 2.6 është ofrluar me çmim 10€ m3, ndërsa nevoiten 0.3m3 për një 1m që kushton 3€

Pozicioni 2.7 është ofrluar me çmim 0.15€

Pozicioni 2.9 është ofrluar me çmim 8€

Pozicioni 2.13 ofrluar me çmim 0.10€

Pozicioni 2,14 është ofrluar me çmim 0.10€

Pozicioni 3.1 është ofrluar me çmim 0.10€

Pozicioni është ofrluar me çmim 0.20€

Totali i çmimve për 1 m si mbas ofrlës: 55.48€

Më poshtë po paraqesim konstaton e furnizimit të materialeve dhe vendosjen në vepër të policioneve të sipërme:

Pozicioni 1,2, kostoja e ekzekutimit të punimeve 1.2€

Pozicioni 1.3, kostoja e ekzekutimit të punimeve 1.4€

Pozicioni: 2,2; 2,3; 2,4 (pozicionet për germim) Kostoja e ekzekutimit të punimeve 40

Pozicioni kostoja e ekzekutimit të punimeve 3€

Pozicioni kostoja e ekzekutimit të punimeve 2€

Pozicioni kostoja e ekzekutimit të punimeve 0.15€

Pozicioni 2.9 kostoja e furnizimit dhe ekzekutimit 7€

Pozicioni 2.13 kostoja e ekzekutimit të punimeve 1€

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**DESHISHKU GB SH.P.K.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Zgjerimi i rrjetit të Kanalizimit, pastrimi i kanalizimit, Pusetave dhe shtratit të lumejve në Qytet dhe Periferi.**” me numër të prokurimit: “**642-23-849-5-1-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KUVENDI KOMUNAL MITROVICË**

Pozicioni 2,14 kostoja e furnizimit dhe ekzekutimit

Pozicioni 3.1 kostoja e furnizimit dhe ekzekutimit 10€

DESHISHKU GB

Pozicioni kostoja e turnimit dite ekzekutimit 9C

Totali i koston për furnizimin dhe ekzekutimin e liganalizimit për 1m: 47,75C

Përgjigjia për kërkesen or. 3:

Ne si OE kemi eksperience të mjaftueshme dhe kapacitete profesionale, teknike dhe financiare për të ekzekutuar tenderin në fialë me shumë suksese. Ne konsiderojmë që Simet tona janë të favorshme për AK si dhe për neve si OC, të njetat poashtu janë çmime të tregut (111c shumë normale).

Ni ishe shprehëmi me kontratë, punimet do të ekzekutohen si mbas kërkesave të (lëna nga menaxheri i projektit, duke bërë organizimin e personelit dhe materialit si nevojshme për ekzekutimin e punimeve. Ne me bindje të plotë konsiderojmë që çmimet tona janë normale, laborstune për AK si dhe për neve si

Vëmendje:

Ju si AK, letren standarte e kërkesës për informata rob tendet jo normalisht të ulët dhe jo normalisht të lartë, e keni formuluar me datë 31/08/2023, ndërsa neve na keni dërguar përmes e-prokurimit me datë 01/09/2023, në ora 16:17, ditë e prerë, mbas orarit të punës, ndërsa keni kërkuar që informatat duhet të ngarkohen brenda 3 ditëve nga data e kësaj kërkesë (31/08/2023), Konsiderojmë që këtë kërkesë e keni dërguar qëllimisht një ditë mbas formolimit të sajë, dhe të njeten e keni ngarkuar mbas orarit të punës me qëllim që ne mos të mundemi të ju japim një përgjigje.

Mbetemi me shprehje që sqarimet tona të shqyrtohen me kujdes dhe në mënyrë të drejtë, dhe të na shprehëmi me Kontratë në mënyrë që ne mos të kemi nevojë që të bëjmë ankesë në OSHP; pasi në Gjykatatë kompetente për ecurin e kësaj procedure të prokurimit dhe për dëmet materiale dhe dëmet e imazhit që na janë shkaktuar, si dhe shqetësimet tona do të shpalosim te mediet të cilat i trajtojnë këto çështje



Përgjigjet e dërguara nga ana e jonë janë plotësisht të arsyeshme, të argumentuara dhe tregojnë seriozitetin e kompanisë tonë në kryerjen e këtyre punëve për çka ne jemi të specializuar në këtë lëmi si nga ana e kapaciteteve teknike profesionale poashtu edhe nga ana e resurseve njerëzore profesionale. Siç shihet edhe në shkresën e lartëcekur këtu kemi të bëjmë me ndërlidhshmëri të pozicioneve në kryerjen e punëve sepse kjo kontratë është "Punë " dhe për të kryer 1m kanalizim duhet bërë gërmimi i kanalit, planifikimi i fundit të kanalit si dhe shtrija e zhavorit si dhe instalimi i gypave të kanalizimit, mbulimi me zhavor si dhe mbulimi i kanalit me dhe ose me zhavor varsisht nga vendi ku ekzekutohen punimet...etj pra domosdo nërlidhen një mori pozicionesh për të kryer këto punë, prandaj nuk mundet në këtë llojë kontrate të konsiderosh një pozicionë si abnormalisht të ulët

pa marrë në konsideratë edhe pozicionet tjera që ndërlidhen për të ekezekutuar në shembullin më të thjeshtë 1m kanalizim, në ekzekutimin e 1m kanalizim nga fillimi deri në përfundim del që çmimet tona janë në harmoni me çmimet aktuale të tregut.

Vlenë të theksohet që AK — Mitrovicë ka formuluar Letren Standarte për informata tender jo-normalisht të ulët, me datë 31.08.2023, ndërsa neve na ka derguar me datë 01.09.2023 (ditë e premte) në ora 16:17, ndërsa ka kërkuar që informatat e kërkuara të dergohen brenda 3 ditëve nga data e kësaj kërkesë (31.08.23). Ne konsiderojmë që AK me qëllim na ka derguar pyetje në kohën e pushimit me qëllim që ne mos të arrijmë të përgjigjemi me kohë dhe si duhet, pastaj qëllimi i AK të shpërblejë me kontratë prapë OE që e ka shpallur në vendimin e datës 05.04.2023.

Andaj, refuzimi i shkresës së lartëcekur me përgjigje të argumentuara si dhe refuzimi i Kërkesës për Rishqyrtim, me arsyetimet nga ana e AK Mitrovicë të pa bazuara, të pa argumentuara, tendencioze, vetëm e shpërfaqin tanimë hapur DISKRIMINIMIN që po na bëhet neve si Operatorë Ekonomik, në kundërshtim me Neni 7, par 1, 2, 4 dhe 6 të LPP-se, Ndërimi i arsyetimit për eliminim sipas vendimit të datës: 05.04.2023 dhe tani sipas vendimit të fundit: 22.09.2023 ndaj nesh tregon joseriozitetin, jo profesionalizmin e AK — Mitrovicë tanimë duke nxjerr vendim të bazuar në nene, paragrafe dhe dokumente të shfuqizuara si dhe në kundërshtim dhe në shkelje të dispozitave të par (d), (e), (h), (o), të nenit 97 të rregullores RRPP-së nr.001/2022.

Gjithashtu arsyetimi i Autoritetit Kontraktues në refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, se kinse kemi dërguar dokumentin në KRPP dhe kemi pritur afatin e kthimit të përgjigjeve të tyre, theksohet me qëllim që të krijohet hamendje tek ne, mirëpo ne ju sqarojmë se jemi mjaftë vigilent dhe e dijmë shumë mirë se është kjo vetëm një veprim procedural obligativ për qdo autoritet kontraktues kurdo që refuzon një tender për çmime jo-normalisht të ulëta dhe përgjegjësia për këto veprime i takon vetëm Autoritetit Kontraktues, andaj është e kotë të përmendet ky veprim procedural i AK-së në mënyrë që të tingëllojë e të krijojë hamendje se kinse Vendimi i AK-së është i arsyeshëm.

Anulimi i procedurës së prokurimit nga AK Mitrovicë, në mënyrë diskriminuese ka vetëm një arsye të vërtetë dhe ajo është: vetëm se ne jemi me çmimin më të lirë si ofertë plotësisht epërgjegjshme. Po ta shikosh vetëm renditjen e çmimeve dhe diferencën e ngushtë tre ofertuesve të parë në procesverbalin e hapjes tregon se çmimet janë reale, në harmoni me çmimet aktuale të tregut dhe nuk ka të bëjë fare me çmime jo-normalisht të ulëta. (Shih mëposhtë renditjen e ofertuesve.)

Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues : Zgjerimi i rrjetit të Kanalizimit, pastrimi i kanalizimit, Pusetave dhe shtratit të lumejve në Qytet dhe Periferi.

Nr. i rokurimit

642-22-849-5-1-1

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**DESHISHKU GB SH.P.K.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Zgjerimi i rrjetit të Kanalizimit, pastrimi i kanalizimit, Pusetave dhe shtratit të lumenjve në Qytet dhe Periferi.**” me numër të prokurimit: “**642-23-849-5-1-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KUVENDI KOMUNAL MITROVICË**

Nr i brendshëm		642/22/025/511
Radhë	Emri dhe Adresa e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në tender (rocedur).	Vlera totale e ofertes
1	"EURONDERTIML SH.P.K. Rr. Azem Behrami, Mitrovica 810108995	10,15
2	Grupi i Operatorëve Ekonomik GASHI ING SH,P.K; DESHISHKU GB SH.P.K. Nebih Hodo kuqi, Nr 3 Suharekë	9.85
3.	Gani Mlinaku B.I, PARKU FEHMI DHE XHEVË LLADROVCI, MITROVICË 810559263	12.62
4.	Grup i Operatorëve Ekonomik Valdrini sh,p.k: Luigj Kastlati B.I. FEHMI LLADROVCI BLLOKU 7 BANESA 4 GLLOGOC	133.17

ME këtë diferencë të ngushtë të çmimeve nuk mund të plotësohen kushtet si në shembullin 1 të ilustruar në mënyrë të kjashtë në Nenin 11. par, Tenderët Jo-norma/isht të Ulët të UDHEZUESIT Nr.001/2023 PER PROKURIMIN PUBLIK. Pra AK - Mitrovicë ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e lartëcekura dhe nuk ka ofruar asnjë [logaritje se si ka ardhur deri te pnimetjonormalisht të ulëta, mirëpo këtë konstatim e ka të bazuar vetëm në mënyrë hipotetike.

Poashtuju njoftojm që me datë 24.07.2023 e kemi njoftuar AK-Mitrovicë që jemi në pritje të na njoftoni se sa duhet të zgjasim sigurimin e tenderit pasi i njeiti i ka skaduar afati dhe kemi kërkuar të na njoftojnë sa sa duhet të zgjasim sigurimin e tenderit, AK nuk na është përgjigjur fare, ne kemi pritur një përgjigje por e njeta nuk na është dërguar nga AK, pastaj ne me date 21.08.2023 e kemi zgjatur sigurimin e tenderit per 120 ditë.

Ne konsiderojm që AK e ka për obligim të kërkojë nga OE të zgjasin validitetin e ofertës dhe sigurimin e tenderit, në rastin tonë dyshojmë që AK me qëllim nuk ka kthyer përgjigjen tonë, që pastaj të gjejë arsye të na eliminoj si të papërgjegjshëm, (dëshmin e kërkesës e gjeni të ngarkur).

Andaj, vendimi i AK- Mitrovicë është i Pa Bazuar.

Dihet mirë se kur mund të anulohet aktiviteti i prokurimit pas hapjes së ofertave:

Pra, Autoriteti Kontraktues, në kundërshtim me dispozitat e LPP-së Neni 62, Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit, par 1, 1. 1, 2, 2.1 si dhe nenit 43 të RRPP-s, par, 43,5, 43.7, nxjerr vendim mbi Anulimin e aktivitetit të prokurimit , i kujtojmë AK se cdo veprim jashtë këtyre neneve është në kundërshtim me legjislacionin primar dhe sekundar në fuqi Për Prokurim Publik, andaj AK-ja nxjerr vendim të pabazuar në legjislacion, të pa argumentuar dhe madje të bazuar në dokumente të shfuqizuara.

Prandaj, me te drejtë e kundërshtojmë vendimin e AK të datës: 22.09.2023 sepse, është nxjerrë një Shkelje të dispozitave të lartëcekura dhe në shkelje të dispozitave par (d), (e), (h), (o), të nenit 97 të rregullores RRPP 01/2022, Për shkak të mos respektimit dhe shkeljeve të parimeve themelore të prokurimit publik të përcaktuar me LPP dhe në trajtim jo të barabartë të ofettuesve gjatë ushtrimit të procedurave të prokurimit.

Rrjedhimisht, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik ta trajtojë Ankesën në kuptim të nenit 4.3. të RRPP 01/2022, sepse jemi të përgjegjshëm dhe kemi ofruar qmimin me të ulët, prandaj kërkojmë nga OSHP-së, ta analizojë ecurinë e procedurës dhe ta Sheh diskriminimin e vazhdueshëm që po na bëhet tashmë me dy vendime nga AK- Mitrovicë, dhe ta trajton në përputhje të plotë me dispozitat e LPP-se dhe rregulloreve në fuqi dhe argumenteve të prezantuara dhe ti korigjojë, veprimet diskriminuese dhe të njëanshëm të Autoritetit Kontraktues duke nxjerrë vendim:

VENDIM

Të nxjerr vendim meritore me të cilin të aprovoj Ankesën të bazuar të paraqitur nga "Gashi ing"SH.P.K& DESHISHKU GB SH.P.K

Të anulohet vendimin e AK-KUVENDI KOMUNAL MITROVICE, të datës 22.09.2023 sepse "Gashi ing"SH.P.K& DESHISHKU GB SH.P.K ka dorzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin me të ulët:

Dhe gjatë rivlersimit të nxjerrë vendim meritore duke shpërlyer me kontratë Operatorët e përgjegjshëm me çmim më të ulët: "Gshi ing"SH.P.K& DESHISHKU GB SH.P.K

Mbetet me shpresë se ankesa jonë do të shqyrtohet pozitivisht .

Me respekt Gentian Deshishku

Demet Materiale :

Shpenzimet në sigurimin e tenderit, Kostoja e pergaditjes së ankesës ,stresi dhe depresioni që

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtuar nga OE “**DESHISHKU GB SH.P.K.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Zgjerimi i rrjetit të Kanalizimit, pastrimi i kanalizimit, Pusetave dhe shtratit të lumenjve në Qytet dhe Periferi.**” me numër të prokurimit: “**642-23-849-5-1-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KUVENDI KOMUNAL MITROVICË**

po perjetojm nga diskriminimi i vazhdueshëm dokumentet per pergaditjen e tenderit per konkurim .Demi ekonomik dhe financiar i fitimit te planifikuar ,humbja e imazhit etj.

KRITERET PËR VLERËSIM

Rregulloren për tenderët Jo-Normalisht të ulët - Rregullores nr. 01/2022 të prokurimit publik

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Komisioni i Vlersimit ka rekomanduar: Të gjithë O.E. kanë ofertuar me qmime JO normalisht te ulta dhe dhe me qmime JO normalisht te larta ku edhe pas pergjigjeve te marra nga O.E. pas kërkesave për sqarime shtesë për qmime Jo normalisht te ulta dhe JO normalisht te larta pergjigjet e marra nuk janë përgjigjëje te kënaqshme per komisionin dhe pa kurfar argumenti shtesë për kto arsye AK anulon Proceduren e Prokurimit duke e njoftuar edhe KRPP-në me formularin sipas nenit 61 te LPP_së.

Ndersa me daten 22.09.2023 Udhëheqsi i Departamentit të Prokurimit i AK- ka marr vendim që në bazë të raportit të vlersimit të publikoj njoftimin mbi vendimin e AK dhe të anuloj Aktivitetin e prokurimit në munges të OE të përgjegjeshem.

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**DESHISHKU GB SH.P.K.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Zgjerimi i rrjetit të Kanalizimit, pastrimi i kanalizimit, Pusetave dhe shtratit të lumenjve në Qytet dhe Periferi.**” me numër të prokurimit: “**642-23-849-5-1-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KUVENDI KOMUNAL MITROVICË**

OE ankues ?sht? pal? me interes,sepse i njeiti është ofertues

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Vendimi i OSHP:2023/0206

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **DESHISHKU GB SH.P.K.**

Përgjigje në Pretendimi nr.1 .

OE”Gashi Ing SHPK & Deshishku GB SHPK - pretendon se Autoritetit Kontraktues Kuvendi Komunal Mitrovicë nuk e ka respektuar nenin 1 të LPP-së ,

Eksperti thekson se ndër të tjera qellim i këtij neni është të sigurojë mënyrë ma efikase ,me transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike ,duke përcaktuar kushtet rregullat qe do te zbatohen , procedurat qe do te ndiqen ,te drejtat qe do te respektohen dhe detyrimet qe do të përmbushen.

Nder të tjera pretendimi i OE ankues lidhur me shkeljen e nenin1 të LPP-së,shih pretendimin :

Autoriteti kontraktues nuk e ka respektuar nenin 1 të LPP-së, pasi na ka eliminuar neve edhe pse i kemi plotësuar te gjitha kriteret e parapara dhe kemi qenë ofertues me çmim më të lirë .

Eksperti thekson se pretendimi i OE ankues qendron pjesërisht ,sepse pa u siguruar siq parashihet me ligj se OE ankues ka çmime jo normalisht të ulëta dhe te larta AK e ka anuluar aktivitetin e prokurimit ku OE ankues ishte ofertues me çmimin më të lirë.(sqarim ma në detale do ta gjeni te pergjigjejet lidhur me pretendimi nr.4. ne këtë raport)

Andaj,

Eksperti konstaton se ky pretendim është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.2 .

OE” Gashi Ing SHPK & Deshishku GB SHPK - pretendon se Autoritetit Kontraktues

Kuvendi Komunal Mitrovicë nuk e ka respektuar nenin 6 të LPP-së ,

Ekspertja thekson se ndër të tjera qellim i këtij neni është të respektohet ekonomiciteti dhe efikasiteti ku të gjitha autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të perdoren në menyrë më ekonomike ,njëkohësisht duke marr në konsideratë qellimin dhe lenden e prokurimit .

Gjithashtu eksperti sqaron nenin 6 i LPP-së është përmendur vetëm sipërfaqsisht,ky nenë ka vetëm dy paragrafe dhe OE ankues nuk ka pasur asnjë pretendim konkret për asnjërin paragraf.

Andaj,

Eksperti konstaton se ky pretendim është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin nr. 3.

OE” Gashi Ing SHPK & Deshishku GB SHPK - pretendon se Autoritetit Kontraktues Kuvendi Komunal Mitrovicë nuk e ka respektuar nenin 7 të LPP-së ,

Eksperti thekson se ndër të tjera qellim i këtij neni është që autoritetet kontraktuese duhet të trajtojnë të gjithë operatorët ekonomik në menyrë të barabartë pa diskriminim si dhe me transparencë, gjatë udhëheqjes së procedurave të prokurimit .

Ndër tjera pretendimi i OE ankues lidhur me shkeljen e parag.1 dhe paragraf.6 të nenin7 të LPP-së,shihë pretendimin:

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, ku edhe pse ne i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë edhe pas vendimit të OSHP-së AK ka gjetur arsye tjera për eliminimin e ofertes tonë .

Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Eksperti sqaron se pa u sqaruar plotësisht se tenderi -oferta ka ose jo çmime jo normalisht të uleta dhe jo normalisht të larta duke bërë ndonjë krahasim që lejohet ligjrisht oferta nuk mundë të eliminohet sikur në rastin konkret .

E sa i përket paragrafit 6 të nenit 7 i njëjti pretendim nuk qendron sepse AK nuk ka shpallur asnjë ofertues fitues por e ka anuluar aktivitetin e prokurimit .

Andaj,

Eksperti konstaton se ky pretendim është pjesërisht i bazuar .

Përgjigje në Pretendimin nr. 4.

OE” Gashi Ing SHPK & Deshishku GB SHPK - pretendon se Autoritetit Kontraktues Kuvendi Komunal Mitrovicë nuk e ka respektuar nenin 59 të LPP-së ,

Eksperti thekson se qëllim i këtij neni është Ekzaminimi vlerësimi dhe Krahاسimi i Tenderëve , fillimisht autoriteti kontraktues ka themeluar komision të Ri-vlerësimit .

OE ankues ndër të tjera pretendon se vlerësimi nuk është bërë komforë nenit 59 të LPP-së , sepse vendimi është nxjerrë në Shkelje të dispozitave të lartë cekura, madje ky vendim përveq që është diskriminues është edhe skandaloz Për faktin se është thirrur në Rregulloren për tenderët Jo-Normalisht të ulët e cila është e shfuqizuar me hyrjen në fuqi të Rregullores nr. 01/2022 të prokurimit publik (RRPP) me datë: 01.11.2022 (Shih argumentin).

Neni 102

Dispozitat e shruqizimit

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohen:

A01 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik — të datës 01.02.2021

2. Udhëzimi Administrativ Nn. 1/2019

3, B57 Rregullat për tenderet Jo-Normalisht të ulët

71, F03 Rregullat për parashtrimin e ankesave

Rregullore Nr. 2/2017 për procedurat e dhënies dhe revokimit të certifikates profesionale për prokurimin publik

6, 1159 Rregullat për Shërbime të veqanta (Konsulentët/Kontraktorët individual) (18.11.

Eksperti konstaton se qëndron pretendimi i OE ankues sepse Rregullorja për tenderët Jo-Normalisht të ulët , është e shfuqizuar me hyrjen në fuqi të Rregullores nr. 01/2022 të prokurimit publik (RRPP), mirëpo edhe sikur të ishte në fuqi e njëjta rregullore për rastin konkret e njëjta nuk do mundë të aplikohet sepse kemi të bëjmë me çmime me Poentim.

Shih nenin 27.13 dhe 27.15 të Rregullores nr. 01/2022 të prokurimit publik (RRPP)

7.13 Gjatë përdorimit të kriterit çmimi më i ulët, duke peshuar çmimet, çmimet e peshuar bazohen në çmimin e ofruar nga Operatorët Ekonomik individual, prandaj nuk lejohet që të përcaktohen pikët duke krahasuar çmimet e ofertuesve të ndryshëm.

27.15 Nuk lejohet krahasimi i çmimeve të ofertave të ndryshme me njëra-tjetrën dhe të konvertohen vlerat e llogaritura në pikë, mandej të peshohen pikët pasi që në këtë mënyrë

pikët më të larta të poentuar jo domosdoshmërisht do të rezultojnë në çmimin më të ulët.

AK ka bërë krahasimin e ofertave njera me tjetren duke e përdorur aplikuar „Rregullorja për tenderët Jo-Normalisht të ulëta cila edhe në atë kohë ishte e shfuqizuar edhe pse kur kemi të bëjmë me çmime me poentim të njëjta rregullore nuk aplikohet edhe para shfuqizimit të saj.

Eksperti sqaron se AK nuk ka përdorur metoda të lejuara gjatë procesit të Rivlersimit dhe nuk ka arritur të bëjë vlerësim se a janë apo jo ofertat me çmime jo normalisht të ulëta apo të larta sepse nuk ka ndonjë dëshmi se ka bërë hulumtim të tregut, nuk ka ndonjë dëshmi se ka bërë ndonjë krahasim me ndonjë kontratë parapara dhe nuk ka ndonjë dëshmi se ka bërë ndonjë hulumtim tjetër të lejuar.

Andaj,

Eksperti konstaton se ky pretendim është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr. 5.

OE” Gashi Ing SHPK & Deshishku GB SHPK - pretendon se Autoritetit Kontraktues Kuvendi Komunal Mitrovicë nuk e ka respektuar nenin 60 të LPP-së,

Eksperti thekson se qëllimi i nenit 60 është vendosja e kriterit dhe se kriteri në DT. ishte të shpërblehet me kontratë Ofertuesi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët të peshuar.

Eksperti sqaron se pretendimi është i pa bazuar sepse me kontratë nuk është shpërblyer asnjë Operator Ekonomik që ishte me çmim më të lartë se sa oferta e OE ankues.

Andaj,

Eksperti konstaton se ky pretendim është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.6 .

OE” Gashi Ing SHPK & Deshishku GB SHPK - pretendon se Autoritetit Kontraktues Kuvendi Komunal Mitrovicë nuk e ka respektuar par 43.5 dhe 43.7 të nenit 43 të Rregullores nr 01/2022 për prokurim publik (RRPP),

Eksperti sqaron se ky nen ka për qëllim të udhëzojë AK se në cilat raste parashihet të bëhet ndërprerja e procedurave të prokurimit.

Eksperti sqaron se ky pretendim është pjesërisht i bazuar sepse siq u sqarua në pretendimin nr. 4 aktiviteti u anulua pa u siguruar se ishte apo jo ofertë me çmime jo normalisht të ulëta dhe të larta, me këtë dispozitë parashihen nga pika a. deri te pika k. se për cilat raste procedura e prokurimit anulohet për ndonjë arsye pas hapjes.

Nëse vërtetohet se çmimet janë jo normalisht të ulëta dhe të larta anulimi do gjente bazën ligjore, ku decidivisht thuhet te pika b. asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i

pergjegjeshëm.

Andaj

Eksperti konstaton se ky pretendim është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.7 .

OE” Gashi Ing SHPK & Deshishku GB SHPK - pretendon se Autoritetit Kontraktues Kuvendi Komunal Mitrovicë nuk e ka respektuar paragrafin 97.1 nën par(d) ,(e),(h),(o). të nenin 97 të Rregulloresnr 01/2022 për prokurim publik(RRPP),

Eksperti sqaron se ky nenë ka për qëllim të udhëzojë AK se cilat janë shkelje të rënda sipas pikave të OE ankues: mosrespektimi i parimeve të prokurimit ,trajtimit të kërkesave për rishqyrtim ,mosrespektim i vendimit të OSHP-së ,sjellje të gabuar dhe jo profesionale.

Eksperti sqaron se nuk qëndron pretendimi i OE ankues lidhur me pretendimet sepse janë zbatuar procedurat mirëpo mënyra e përgjigjeve dhe mënyra e të shkruarit është relative andaj në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me shkelje të rënda nga Zyrtari i Prokurimit edhe vendimi i OSHP-së ishte respektuar nga ana e AK-së .

Andaj

Eksperti konstaton se ky pretendim është i pa bazuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtuar nga OE “**DESHISHKU GB SH.P.K.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Zgjerimi i rrjetit të Kanalizimit, pastrimi i kanalizimit, Pusetave dhe shtratit të lumenjve në Qytet dhe Periferi.**” me numër të prokurimit: “**642-23-849-5-1-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KUVENDI KOMUNAL MITROVICË**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI KOMUNAL MITROVICË**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **DESHISHKU GB SH.P.K.**

Bujar Lushaku

